

**PASQYRIME MBI PIKËPAMJET E QYTETARËVE NË PERIUDHËN
2020-2022:**

INTEGRIMI NË BE, MARRËDHËNIET KOSOVË-SERBI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL



Autorë:

Gramos Sejdiu dhe Dea Fetiu

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e iniciuar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme lidhur me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:



**PASQYRIME MBI PIKËPAMJET E QYTETARËVE NË PERIU DHËN
2020-2022:**

INTEGRIMI NË BE, MARRËDHËNIET KOSOVË-SERBI DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive.....	1
Hyrje	2
Metodologjia.....	3
Kapitulli 1: Integrimi në BE.....	4
Kapitulli 2: Dialogu dhe Marrëdhëniet Kosovë – Serbi	5
Kapitulli 2.1: Procesi i dialogut	5
Kapitulli 2.2: Marrëdhëniet Kosovë–Serbi.....	7
Kapitulli 3: Bashkëpunimi Rajonal dhe Iniciativa Ballkani i Hapur	10
Përfundimet	13

TABELA E FIGURAVE

Tabela 1	BSBP 2022- Mbështetja e qytetarëve për integrimin e Kosovës në BE	4
Tabela 2	BSBP 2022- Perceptimet e qytetarëve për gatishmërinë e BE-së për të pranuar Kosovën si shtet anëtar	4
Tabela 3	BSBP 2021-2022- Perceptimi i qytetarëve për mbështetjen e dialogut Kosovë – Serbi	5
Tabela 4	BSBP 2022- Perceptimi i qytetarëve lidhur me kahjen e dialogut Kosovë – Serbi	5
Tabela 5	BSBP 2020-2022- Perceptimi i qytetarëve për përmirësimin e pozitës së Kosovës në dialog nga qeveria aktuale	6
Tabela 6	BSBP 2021-2022- Perceptimet e qytetarëve lidhur me besimin e tyre se kush duhet ta ndërmjetësojë dialogun Kosovë – Serbi	6
Tabela 7	BSBP 2020-2022- Perceptimet e qytetarëve lidhur me ndikimin e dialogut në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	7
Tabela 8	BSBP 2022- Perceptimi i qytetarëve për pasojat nëse dështon dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	8
Tabela 9	BSBP 2021-2022- Perceptimet e qytetarëve për mundësinë që Kosova dhe Serbia të arrijnë një marrëveshje përfundimtare	8
Tabela 10	BSBP 2022- Perceptimet e qytetarëve për mundësinë e një lufte të re ndërmjet Kosovës dhe Serbisë	9
Tabela 11	BSBP 2020-2022 – Perceptimet e qytetarëve për mbështetjen e tyre në idenë e krijimit të të ashtuquajturit “Mini-Shengeni i Ballkanit Perëndimor”, i quajtur më vonë në “Iniciativa e Ballkanit të Hapur”	11
Tabela 12	BSBP 2022 – Perceptimi i qytetarëve për bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor	11
Tabela 13	BSBP 2021-2022 – Perceptimet e qytetarëve për mbështetjen e lëvizjes së lirë, shkëmbimit të informacionit dhe një tregu të përbashkët për mallrat dhe fuqinë punëtore në Ballkanin Perëndimor	12

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport i Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor analizon perceptimet e qytetarëve të Kosovës për integrimin në BE, marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe bashkëpunimin rajonal.

Gjatë periudhës sonë të anketimit, perceptimi publik për integrimin në BE ka pasur vazhdimisht një nivel të lartë mbështetjeje. Në vitin 2020, 92,5 përqind e qytetarëve shprehën mbështetje, e ndjekur me 92,3 përqind në vitin 2021 dhe 94,2 përqind në vitin 2022. Këto gjetje tregojnë një nivel të qëndrueshëm dhe të lartë të mbështetjes për procesin e integrit, pa ndryshime të dukshme gjatë tre viteve të fundit.

Duke iu referuar perceptimeve të qytetarëve për marrëdhëniet bilaterale Kosovë-Serbi dhe procesin e dialogut, pjesa e dytë e raportit nxjerrë në pah rritjen e mbështetjes për dialogun mes qytetarëve të Kosovës. Në vitin 2021, 74.3 përqind shprehën mbështetjen e tyre për dialogun, i cili u rrit në vitin 2022 në 83 përqind. Për më tepër, kapitulli prekë ndryshimin e këndvështrimeve të qytetarëve për ndikimin e dialogut në marrëdhëniet Kosovë-Serbi, ku 40 përqind e të anketuarve besojnë se është përmirësuar në vitin 2022 krahasuar me 14.6 përqind në vitin 2021.

Shumica e të anketuarve (68.8 përqind) shprehën mbështetjen për bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor, duke treguar një prirje pozitive në mesin e popullatës së Kosovës. Për më tepër, të anketuarit shprehën vazhdimisht mbështetje për lëvizjen e lirë, shkëmbimin e informacionit dhe krijimin e një tregu të përbashkët për mallrat dhe fuqinë punëtore në Ballkanin Perëndimor. Për pyetjen specifike në lidhje me Iniciativën Ballkani i Hapur, përgjigjet ishin shumë të ndara dhe të ndryshme gjatë viteve, me nivele të luhatshme të mbështetjes dhe kundërshtimit.

Në përgjithësi, gjetjet nxjerrin në pah aspiratën e fortë të qytetarëve të Kosovës për integrim në BE dhe vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke u kuptuar kompleksiteti dhe sfidat e të dy proceseve.

HYRJE

Procesi i integritimit në Bashkimin Evropian (BE), dialogu në zhvillim e sipër ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, bashkëpunimi rajonal dhe i ashtuquajturit “Ballkani i Hapur” kanë qenë prej kohësh tema qendrore në kontekstin e Ballkanit Perëndimor. Këto përpjekje kanë një rëndësi të madhe për stabilitetin politik të rajonit, zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal. Perceptimet publike në lidhje me këto vështirësi luajnë një rol kyç në formësimin e aspiratave, shqetësimeve dhe pritshmërive të qytetarëve të prekur drejtpërdrejt nga këto procese. Të kuptuarit e dinamikës së opinionit publik është thelbësor për politikëbërësit e përfshirë në këto procese për të nxitur dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, integritimin evropian dhe të kuptuarit e “Ballkanit të Hapur”.

Ky raport është i ndarë në tre kapituj kryesorë. Kapitulli i parë synon të trajtojë perspektivën publike në Kosovë lidhur me integritimin në BE, duke ofruar njohuri mbi pikëpamjet e qytetarëve për anëtarësimin në BE dhe besimet e tyre në lidhje me gatishmërinë e BE-së për të pranuar vendet e tyre përkatëse si shtete anëtare. Duke analizuar dhe krahasuar të dhënat e mbledhura gjatë një periudhe trevjeçare (2020–2022), raporti kërkon të identifikojë ndryshimet ose tendencat në perceptimet e publikut. Kapitulli i dytë është i ndarë në dy nënkapituj: së pari, ai shqyrton perceptimin e qytetarëve për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, duke u fokusuar në mbështetjen e tyre për dialogun dhe opinionet e tyre për rrugën e dialogut; së dyti, analizon vlerësimin e qytetarëve për ndikimin e dialogut në marrëdhëniet mes dy vendeve. Kapitulli i tretë paraqet perspektivat e qytetarëve në lidhje me bashkëpunimin rajonal dhe identifikon tendencat dhe ndryshimet e mundshme gjatë periudhës matëse trevjeçare.

Sa i përket metodologjisë, të dhënat e anketës për këtë raport janë mbledhur në kuadër të anketës së Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) përmes intervistave sy më sy me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në mbarë Kosovën. BSBP është projekt rajonal i udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe anketa është kryer njëkohësisht në Shqipëri dhe Serbi. Për zbatimin e këtij projekti, QKSS-ja është në partneritet me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri dhe Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi. Hulumtimi në terren u realizua nga 25 shtatori deri më 2 tetor 2022. Pyetësi i anketës përbëhej kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshinte 1,136 amvisëri. Faza e parë e mostrimit ishte bazuar sipas ndarjeve administrative të Drejtorive Rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rajonet si në vijim: Ferizajit, Gjakovës, Gjiçanit, Mitrovicës Jugore, Mitrovicës Veriore, Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Numri i anketave të kryera në secilin rreth është hartuar proporcionalisht me numrin e popullsisë për secilën komunë brenda qarkut përkatës bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 në Kosovë. Brenda komunave, mostra u shtresua në mostra urbane/rural e bazuar në numrin e amvisërive në secilën zonë.

Modele të rastësishme u përdorën për të zgjedhur amvisëritë brenda vendeve të mostruara, ndërsa rastësia brenda amvisërive u bazua në metodën e ditëlindjes së ardhshme të të personit të rritur. Të dhënat u verifikuan në kohë reale nëpërmjet koordinatorëve në terren të cilët vizituan një mostër të paracaktuar të amvisërive pas përfundimit të anketimit në amvisëritë përkatëse, nëpërmjet kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa prej përgjigjeve kryesore; dhe duke analizuar konsistencën logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzhi i gabimit është 3 për qind me një interval besimi prej 95 për qind.

KAPITULLI 1: INTEGRIMI NË BE

Procesi i integrimit në Bashkimin Evropian (BE) ka një rëndësi të madhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Perspektiva e anëtarësimit në BE është parë prej kohësh si një shtytës kyç për stabilitetin politik, zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin regjional në rajon. Ky kapitull fokusohet në eksplorimin dhe analizimin e perceptimeve të publikut lidhur me integrimin e Kosovës në BE. Kapitulli ofron gjithashtu një krahasim të perceptimeve gjatë tre viteve të fundit. Duke analizuar dhe krahasuar të dhënat e mbledhura nga vitet 2020, 2021 dhe 2022, ne përpiqemi të identifikojmë çdo ndryshim apo trend në perceptimet e publikut me kalimin e kohës.

Sa i përket Kosovës, mbështetja publike për integrimin në BE ka qëndruar vazhdimisht e lartë gjatë tre viteve. Në vitin 2020, 92.5 përqind e qytetarëve shprehën mbështetje për integrimin në BE dhe kjo shifër vetëm pak u ul në vlerë prej 92.3 përqind në vitin 2021. Megjithatë, ka pasur një rritje të lehtë të mbështetjes në vitin 2022, ku 94.2 përqind e qytetarëve kanë shfaqur mbështetjen e tyre. Këto shifra sugjerojnë se në përgjithësi ekziston një nivel i qëndrueshëm dhe i fuqishëm i mbështetjes për integrimin e Kosovës në BE, pa ndryshime të dukshme gjatë periudhës trevjeçare.

Tabela 1 BSBP 2020-2022 MBËSHTETJA E QYTETARËVE PËR INTEGRIMIN E KOSOVËS NË BE

A E PËRKRAHNI INTEGRIMIN E KOSOVËS NË BE?		Po	Jo	Nuk e di
	2020	92.5%	3.2%	4.3%
	2021	92.3%	4.1%	3.6%
	2022	94.3%	3.5%	2.2%

Ky edicion i BSBP ka pyetur gjithashtu qytetarët se si e perceptojnë gatishmërinë e BE-së për të pranuar Kosovën në Bashkësinë Evropiane. Në këtë kuptim, të dhënat tregojnë disa ndryshime në perceptimet e të anketuarve për gatishmërinë për BE-në gjatë një periudhe trevjeçare. Në vitin 2020, 38.2 përqind besonin se BE-ja ishte e gatshme ta pranonte Kosovën si shtet anëtar, ndërsa 38.9 përqind mendonin se pranimi do të ndodhte në të ardhmen (+ 2 vite). Megjithatë, pati një rënie të lehtë në këto shifra në vitin 2021, me 33.6 përqind që shprehën besimin në gatishmërinë e BE-së dhe 40.7 përqind parashikonin pranimin në të ardhmen e afërt. Në vitin 2022, pati një rritje të dukshme, me 45.6 përqind që perceptojnë gatishmërinë e BE-së dhe 38.9 përqind parashikojnë pranim në të ardhmen e afërt. Këto gjetje tregojnë disa luhajtje në perceptime, por në përgjithësi, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve mbetën me shpresë për gatishmërinë e BE-së për të pranuar Kosovën si shtet anëtar.

Tabela 2 BSBP 2020-2022 PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR GATISHMËRINË E BE-SË PËR TË PRANUAR KOSOVËN SI SHTET ANËTAR

A MENDONI SE BE-JA ËSHTË E GATSHME TA PRANOJË VENDIN TUAJ SI SHTET ANËTAR?		Po	Po, por jo në të ardhmen e afërt (+ 2 vite)	Jo	Nuk e di
	2020	38.2%	38.9%	15.5%	7.4%
	2021	33.6%	40.7%	19.8%	5.9%
	2022	45.6%	38.9%	11.8%	3.7%




KAPITULLI 2: DIALOGU DHE MARRËDHËNIET KOSOVË – SERBI

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i nisur në vitin 2011, ka ofruar një platformë të rëndësishme për adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve sfiduese që përcjellin marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Ky dialog bilateral, i ndihmuar nga Bashkimi Evropian (BE), ka një rëndësi të madhe pasi synon të trajtojë sfidat e kahershme politike, shoqërore dhe ekonomike në rajon. Përmes këtij kapitulli, ne përpiqemi të analizojmë se si qytetarët e Kosovës e shohin procesin e dialogut dhe marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në përgjithësi. Kapitulli është i strukturuar në dy seksione. Së pari, i shqyrtojmë perceptimet e qytetarëve për procesin e dialogut, suksesin e tij dhe rezultatet e mundshme. Së dyti, i analizojmë perceptimet e qytetarëve për marrëdhëniet Kosovë-Serbi në përgjithësi.

Kapitulli 2.1: Procesi i dialogut


Kur krahasohen perceptimet e qytetarëve të Kosovës për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vitin 2021 dhe 2022, mund të vërehen ndryshime të rëndësishme në trende. Në vitin 2021, 74.3 përqind e të anketuarve shprehën mbështetje për dialogun, ndërsa 21 përqind e kundërshtuan atë, ndërsa 4.7 përqind deklaruan se ishin të papërcaktuar. Në vitin 2022, 83 përqind e të anketuarve shprehën mbështetje për dialogun, ndërsa vetëm 13,5 përqind e kundërshtuan atë. Këto të dhëna tregojnë një rritje të konsiderueshme të mbështetjes për dialogun, duke reflektuar një rritje të mundshme në kuptimin dhe vlerësimin e vlerës së dialogut si mjet për nxitjen e bashkëpunimit, stabilitetit dhe zgjidhjes së qëndrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Tabela 3 BSBP 2021-2022- PERCEPTIMI I QYTETARËVE LIDHUR ME MBËSHTETJEN E DIALOGUT KOSOVË – SERBI

A MENDONI SE BE-JA ËSHTË E GATSHME TA PRANOJË VENDIN TUAJ SI SHTET ANËTAR?		Po	Po, por jo në të ardhmen e afërt (+ 2 vite)	Jo	Nuk e di
		2020 	38.2%	38.9%	15.5%
2021 	33.6%	40.7%	19.8%	5.9%	
2022 	45.6%	38.9%	11.8%	3.7%	

Në vitin 2022, BSBP bëri matje edhe perceptimeve të të anketuarve në lidhje me drejtimin që po ecën procesi i dialogut. Rezultatet tregojnë se 48.9 përqind e të anketuarve besojnë se dialogu po shkon në drejtimin e duhur, ndërsa një pjesë e konsiderueshme (41.8 përqind) kanë shfaqur rezerva, duke deklaruar se nuk besojnë se dialogu është në rrugën e duhur. Nga ana tjetër pjesa prej 9.3 përqind e tyre janë përgjigjur me pasiguri lidhur me drejtimin e dialogut.

Tabela 4 BSBP 2022- PERCEPTIMI I QYTETARËVE NË LIDHJE ME DREJTIMIN E DIALOGUT KOSOVË – SERBI

A MENDONI SE DIALOGU KOSOVË – SERBI PO SHKON NË DREJTIMIN E DUHUR?		Po	Jo	Nuk e di
		2022 	48.9%	41.8%

Në anën tjetër, perceptimi i qytetarëve për ndryshimet politike në Kosovë shihet në vlerësimin e tyre për ndikimin e qeverisë aktuale në pozicionin e vendit në dialog. Në mesin e të anketuarve, shumica (50.5 përqind) besojnë se qeveria aktuale ka përmirësuar pozitën e Kosovës në dialog. Një pjesë e konsiderueshme (33.5 përqind) mendojnë se pozita mbetet e pandryshuar, ndërsa një përqindje më e vogël (10.3 përqind) shprehin shqetësimin se qeveria aktuale e ka dobësuar pozitën e Kosovës.

Tabela 5 BSBP 2022 PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PËRMIRËSIMIN E POZITËS SË KOSOVËS NË DIALOG NGA QEVERIA AKTUALE

A BESONI SE QEVERIA AKTUALE E KA PËRMIRËSUAR POZITËN E KOSOVËS NË DIALOG?	2022	Po, pozita e Kosovës është	Jo, pozita e Kosovës është	Jo,	Nuk e di/ Nuk kam
		50.5%	10.3%	33.5%	5.6%

Kur krahasohen të dhënat nga viti 2021 dhe 2022 lidhur me besimin tek ndërmjetësit e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dalin ngjashmëri. Në vitin 2021, shumica e të anketuarve, 49.8 përqind, besimin e tyre i ja japin Shteteve të Bashkuara (SHBA) për të ndërmjetësuar dialogun, ndërsa vetëm 4.3 përqind kishin më shumë besim në BE. Një pjesë tjetër e konsiderueshme, 35.4 përqind, besojnë se si SHBA ashtu edhe BE-ja duhet të ndërmjetësojnë bashkërisht dialogun, ndërsa një përqindje e vogël, 5.5 përqind, mendojnë se as SHBA-ja dhe as BE-ja nuk duhet të përfshihen. Në vitin 2022, besimi në SHBA për të ndërmjetësuar dialogun u ul lehtësisht në 47.9 përqind, ndërsa besimi në BE mbeti relativisht konsistent në 4.8 përqind. Besimi se si SHBA ashtu edhe BE-ja duhet të ndërmjetësojnë bashkërisht dialogun u rrit në 37.6 përqind. Përqindja e të anketuarve që besonin se as SHBA-ja dhe as BE-ja nuk duhet të përfshiheshin mbeti e njëjtë në 5.6 përqind dhe 4.1 përqind nuk kishin asnjë mendim ose ishin të pasigurt. Këto të dhëna, të shoqëruar me perceptimin e 90.8 përqind të të anketuarve për ndikimin e SHBA-së në Kosovë si pozitiv,¹ përforcon pikëpamjen se qytetarët e Kosovës kanë besim më të madh në SHBA në krahasim me BE-në si ndërmjetësues i marrëdhënieve me Serbinë.

Tabela 6 BSBP 2021-2022- PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR BESIMIN E TYRE SE KUSH DUHET TA NDËRMJETËSOJË DIALOGUN KOSOVË – SERBI.

KUJT DO T'I BESONI MË SHUMË PËR TË QENË NDËRMJETËSUES NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI	2021	Unë do t'i besojmë më shumë SHBA-ve	Unë do t'i besojmë më shumë BE-së	SHBA dhe BE duhet të ndërmjetësojnë së bashku	As SHBA dhe as BE nuk duhet të përfshihen në dialog	Nuk e di/Nuk kam mendim
		49.8%	4.3%	35.4%	5.5%	4.9%
2022	47.9%	4.8%	37.6%	5.6%	4.1%	

¹ Barometri i Sigurisë së Ballkanit Perëndimor, 2022, <https://securitybarometer.qkss.org/>




Kapitulli 2.2: Marrëdhëniet Kosovë-Serbi

BSBP gjatë 3 viteve të fundit ka matur rregullisht perceptimet e qytetarëve për marrëdhëniet bilaterale Kosovë-Serbi. Në këtë kontekst, ky nënkapitull fillon me analizimin e perceptimeve mbi ndikimin e dialogut në këto marrëdhënie.

Në vitin 2020, 17 përqind e të anketuarve besonin se dialogu kishte përmirësuar marrëdhëniet mes dy vendeve, ndërsa 16,3 përqind mendonin se marrëdhëniet ishin përkeqësuar. Një shumicë prej (60.2 përqind) i perceptojnë marrëdhëniet si të ngëcura dhe pjesa tjetër prej 6.5 përqind nuk shprehën asnjë mendim. Duke kaluar në vitin 2021, ka pasur një rënie të lehtë të përqindjes së të anketuarve që besonin se dialogu kishte përmirësuar marrëdhëniet, e cila u ul në 14.6 përqind. Në mënyrë të ngjashme, përqindja e atyre që mendonin se marrëdhëniet ishin përkeqësuar u ul në 11.1 përqind. Shumica (69.4 përqind) marrëdhëniet i perceptojnë ende si të njëjta dhe 4.8 përqind shprehën pasiguri.

Megjithatë, në vitin 2022, vërehet një ndryshim thelbësor në perceptime. Përqindja e të anketuarve që besonin se dialogu kishte përmirësuar marrëdhëniet u rrit në 40 përqind, ndërsa përqindja e atyre që mendonin se marrëdhëniet ishin përkeqësuar gjithashtu u rrit në 17.8 përqind. Nga ana tjetër 37.8 përqind mendojnë se marrëdhëniet kanë mbetur të njëjta, ndërsa një përqindje më e vogël (4.3 përqind) shprehën pasiguri. Këto rezultate theksojnë ndikimin e madh të zhvillimeve të vitit të kaluar në dialog, ²duke çuar në ndryshime të rëndësishme në opinionet e njerëzve. Përkatësisht, përqindja e të anketuarve që i perceptojnë marrëdhëniet si të njëjta është ulur ndjeshëm krahasuar me dy vitet e fundit, gjë që tregon një ndryshim të qartë të shkaktuar nga këto zhvillime.

Tabela 7 BSBP 2020-2022- PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR NDIKIMIN E DIALOGUT NË PËRMIRËSIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË.

A MENDONI SE DIALOGU KA PËRMIRËSUAR MARRËDHËNIET NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË?		Marrëdhëniet janë më të këqija	Marrëdhëniet janë më të mira	Marrëdhëniet janë të njëjta	Nuk e di
		2020 	16.3%	17%	60.2%
2021 	11.1%	14.6%	69.4%	4.8%	
2022 	17.8%	40%	37.8%	4.3%	

Në pyetjen për pasojat e mundshme nëse dështon normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të anketuarit dhanë pikëpamje të ndryshme në lidhje me rezultatet e mundshme. Përafërsisht 16.7 përqind e pjesëmarrësve besonin se dështimi i normalizimit do të çonte në një konflikt të drejtpërdrejtë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Deri sa 16.1 përqind të tjerë shprehën shqetësimin se, në një rast të tillë do të rritej numri i përplasjeve ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb në Kosovë dhe Serbi. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 29.4 përqind, sugjerojnë se dështimi i normalizimit do të rezultonte në vazhdimin e konfliktit të ngrirë dhe mbajtjen e status quo-së. Kjo pikëpamje sugjeron një perceptim se mungesa e progresit në marrëdhëniet mund të zgjasë tensionet ekzistuese dhe të parandalojë çdo qëllim të rëndësishëm

² Shih zhvillimet e dialogut 2022 mbi Raportin e Progresit të Kosovës 2022, fq. 79, mund ta gjeni këtu: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>

për një zgjidhje të përhershme. Për më tepër, 31.0 përqind e pjesëmarrësve besonin se dështimi i normalizimit do të pengonte integrimin e Kosovës dhe Serbisë në BE, ndërsa një përqindje e vogël, 2.8 përqind, treguan se nuk besonin se do të ndodhte ndonjë nga pasojat e përmendura më lart.

Këto rezultate demonstrojnë gamën e larmishme të perspektivave që pasqyrojnë natyrën komplekse të çështjes dhe implikimet e saj të mundshme për Kosovën, Serbinë dhe rajonin më të gjerë, nëse dialogu ngeç.

Tabela 8 BSBP 2022- PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR PASOJAT NËSE DËSHTON DIALOGU PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË.

CILAT DO TË ISHIN PASOJAT NËSE DIALOGU PËR NORMALIZIMIN E	2022	Konflikti i drejtpërdrejtë mes Kosovës dhe Serbisë	Rritja e konflikteve ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb	Vazhdon Konflikti i ngrirë dhe Status Quo-ja	Kosova dhe Serbia dështojnë në proceset integruese në BE	Asnjë nga të lart cekurat	Nuk e di/Nuk kam mendim
		16.7%	16.1%	29.4%	31%	2.8%	4.1%

Përgjigjet nga viti 2021 deri në vitin 2022 në lidhje me besimin në arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duket të jenë uniforme. Në të dyja vitet, 12 përqind e të anketuarve shprehën bindjen se një marrëveshje e tillë nuk do të arrihet kurrë. Në mënyrë të ngjashme, 22 përqind e të anketuarve në të dy vitet ishin optimistë dhe besonin se një marrëveshje përfundimtare do të arrihej në të ardhmen e afërt. Shumica e të anketuarve, 61 përqind në vitin 2021 dhe 60,6 përqind në vitin 2022, ndanë mendimin se një marrëveshje përfundimtare do të arrihet përfundimisht, por jo edhe së shpejti. Këto rezultate tregojnë një ndjenjë të vazhdueshme të optimizmit të matur në mesin e të anketuarve, duke pranuar sfidat e përfshira gjatë procesit të dialogut dhe duke mbajtur besimin se një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është e mundur në afat të gjatë.

Tabela 9 BSBP 2021-2022- PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MUNDËSINË QË KOSOVA DHE SERBIA TË ARRIJNË NJË MARRËVESHJE PËRFUNDIMTARE.

A BESONI SE KOSOVA DHE SERBIA DO TË ARRIJNË NJË MARRËVESHJE PËRFUNDIMTARE?	2021	Asnjëherë	Po, në të ardhmen e afërt	Po, por jo edhe së shpejti	Nuk e di/ Nuk kam mendim
			12%	22%	61%
2022	12.2%	22.5%	60.6%	4.8%	

Së fundi, në vitin 2022, të anketuarit u pyetën për perceptimin e tyre për mundësinë e një lufte të re ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rezultatet tregojnë se shumica, 45.2 përqind, besonin se mundësia për një luftë të re nuk ekziston, duke theksuar një ndjenjë mbizotëruese për stabilitet dhe paqe. Për më tepër, 32 përqind e të anketuarve e shihnin mundësinë e tillë si të ulët, duke përforcuar më tej bindjen se gjasat për konflikt të armatosur perceptohen të jenë minimale. Megjithatë, një përqindje e dukshme, 14.6 përqind, ende shprehin shqetësime, duke marrë parasysh mundësinë për një nivel të lartë konflikti. Një përqindje më e vogël, 5.5 përqind, besojnë se potenciali për një luftë të re është shumë i lartë, ndërsa theksojnë se një pjesë e vogël, 2.6 përqind, ose nuk kanë një mendim ose janë të pasigurt për këtë çështje. Në përgjithësi, këto gjetje sugjerojnë një besim të përbashkët mes të anketuarve se potenciali për një luftë të

re ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është përgjithësisht i ulët ose inekzistent, duke treguar një optimizëm shpresëdhënës për paqen dhe stabilitetin e vazhdueshëm në rajon.

Tabela 10 BSBP 2022- PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR POTENCIALIN E NJË LUFTE TË RE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË.

A MENDONI SE KA POTENCIAL PËR NJË LUFTE TË RE MES KOSOVËS DHE SERBISË?	2022	Potenciali është inekzistent	Potenciali është i ulët	Potenciali është i lartë	Potenciali është shumë i lartë	Nuk e di/ Nuk kam mendim
		45.2%	32%	14.6%	5.5%	2.6%

KAPITULLI 3: BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE INICIATIVA BALLKANI I HAPUR

E ndërtuar mbi parimet themelore të Zonës Shengen të BE-së, Iniciativa për Ballkanin e Hapur, e udhëhequr nga liderët e Serbisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, synon të heqë barrierat dhe të promovojë rrjedhën e qetë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve në të gjithë rajonin.³ Ndërkohë që kjo nismë ka një potencial të rëndësishëm për të rritur stabilitetin rajonal, për të forcuar lidhjet ekonomike dhe për të lehtësuar proceset e integritimit në BE për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, Bosnja dhe Hercegovina (B dhe H), Mali i Zi dhe Kosova kanë hezituar t'i bashkohen nismës për arsye të ndryshme. Çështjet e brendshme problematike të Bosnjë dhe Hercegovinës kanë ndarë entitetin serb në mbështetjen e nismës, ndërsa entiteti boshnjak dhe kroat e refuzojnë atë.⁴ Edhe Mali i Zi ka shprehur mungesën e besimit në këtë iniciativë, duke cituar se “vendi është ende larg në rrugën drejt anëtarësimit në BE, dhe se asnjë iniciativë e re nuk duhet të rrezikojë këtë trajektore”⁵ mediat dhe lidhshipi i Kosovës vazhdimisht e kanë portretizuar atë si një platformë në të cilën Kosova nuk përfaqësohet njësoj si palët tjera,⁶ prandaj kjo iniciativë është shëndëruar në një mjet politik që nuk vlerësohet për përmbajtjen e saj. Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të rëndësishme në perceptimin e qytetarëve të Kosovës për Ballkanin e Hapur, mbështetjen e tyre për lëvizjen dhe transportin e lirë të mallrave dhe shërbimeve dhe perceptimin e përbashkët të Iniciativës Ballkani i Hapur si ide në tërësi.

Gjatë periudhës trevjeçare nga viti 2020 deri në vitin 2022, pyetja në lidhje me mbështetjen për idenë e “Mini-Shengenit të Ballkanit Perëndimor”, e quajtur më vonë si Iniciativa “Ballkani i Hapur” iu shtrua të anketuarve. Përgjigjet ndryshuan ndër vite, duke zbuluar disa luhatje në opinionin publik. Në vitin 2020, 38.3 përqind e të anketuarve shprehën mbështetjen e tyre për nismën në fjalë, dhe me një shumicë kundërshtuese prej 53.1 përqind. Një vit më pas, përqindja e mbështetësve u rrit në 42.2 përqind e nga ana tjetër me përqindjen e atyre që kundërshtuan u zvogëlua lehtë në 52.4 përqind. Megjithatë, në vitin 2022, pati një zhvendosje të konsiderueshme, pasi numri i të anketuarve që mbështesnin nismën u ul në 31.4 përqind, ndërsa ata që e kundërshtonin mbetën të stabël në 51.9 përqind. Është interesante se përqindja e të anketuarve që shprehën pasiguri ose nuk kishin një opinion të qartë u rrit ndjeshëm në vitin 2022, duke arritur në 16.7 përqind. Këto gjetje theksojnë qëndrimet e ndryshme në mesin e popullatës së Kosovës dhe theksojnë qartë nevojën për analiza të mëtejshme mbi ndikimin e dëmshëm të portretizimit dhe mbulimit mediatik në perceptimin publik.




3 Elezi, Elona. “Ballkani i Hapur mund të përkeqësojë problemet politike në rajon – DW – 18.08.2022. [dw.com](https://www.dw.com/en/open-balkan-initiative-risks-aggravating-political-problems-in-the-region/a-62834261), 18 gusht 2022. <https://www.dw.com/en/open-balkan-initiative-risks-aggravating-political-problems-in-the-region/a-62834261>.

4 Gaarmann, Margit Wunsch. “Iniciativa ‘Ballkani i Hapur’ plotëson procesin e Berlinit.” Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP), 8 nëntor 2022. <https://www.swp-berlin.org/en/publication/the-open-balkan-initiative-complements-the-berlin-process>.

5 Ibid.


6 “Kurti refuzon ftesën për Samitin e ardhshëm të Ballkanit të Hapur. Prishtina Insight, 3 qershor 2022. <https://prishtinainsight.com/kurti-rejects-invite-to-next-open-balkans-summit/>.

Tabela 11 BSBP 2020–2022 – PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MBËSHTETJEN E TYRE NË IDENË E KRIJIMIT TË TË ASHTUQUAJTURIT “MINI-SHENGENI I BALLKANIT PERËNDIMOR”, I RIEMËRTUAR MË VONË NË “INICIATIVA E BALLKANIT TË HAPUR”.

A E PËRKRAHNI IDENË E KRIJIMIT TË TË ASHTUQUAJTURIT “MINI-SHENGENI I BALLKANIT PERËNDIMOR”, I RIEMËRTUAR MË VONË NË “INICIATIVA E BALLKANIT TË HAPUR”?		Po	Jo	Nuk e di/ Nuk kam mendim
	2020 	38.3%	53.1%	8.6%
2021 	42.2%	52.4%	5.4%	
2022 	31.4%	51.9%	16.7%	



Nga ana tjetër, kur u pyetën për mbështetjen e tyre për bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor, një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (68.8 përqind) shprehën një prirje pozitive drejt nxitjes së një bashkëpunimi të tillë. Anasjelltas, një pjesë e konsiderueshme prej 24.5 përqind shprehën kundërshtime ndaj nismës, ndërsa një përqindje më e vogël (6.7 përqind) thanë se nuk kishin asnjë mendim për të. Këto gjetje pasqyrojnë një shumëllojshmëri të perspektivave brenda shoqërisë kosovare në lidhje me rëndësinë dhe përfitimet e mundshme të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Së bashku me rezultatet nga pyetjet e tjera në këtë kapitull, ato theksojnë nevojën për eksplorim të mëtejshëm dhe informim më të mirë të popullatës lidhur me përfitimet e ndërlidhjes ekonomike, politike dhe shoqërore në përpjekjet të procesit pajtimit.

Tabela 12 BSBP 2022 – PERCEPTIMI I QYTETARËVE LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN RAJONAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR.

A E PËRKRAHNI BASHKËPUNIMIN RAJONAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR?		Po	Jo	Nuk e di/ Nuk kam mendim
	2022 	68.8%	24.5%	6.7%

Si në vitin 2021 ashtu edhe në vitin 2022, BSBP mati qëndrimet e të anketuarve në lidhje me mbështetjen e tyre për lëvizjen e lirë, shkëmbimin e informacionit dhe krijimin e një tregu të përbashkët për mallra dhe fuqinë punëtore në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet tregojnë një prirje të qëndrueshme të mbështetjes për këto aspekte të bashkëpunimit dhe integritit rajonal. Në vitin 2021, rreth 67.2 përqind e të anketuarve deklaruan mbështetjen e tyre, ndërsa në vitin 2022, përqindja u rrit në një masë të vogël në 69.9 përqind. Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve janë shprehur kundër këtyre masave, ku kanë shprehur mosmarrëveshje me 25.6 përqind në vitin 2021 dhe 24 përqind në vitin 2022. Këto gjetje nënvizojnë kompleksitetin e opinionit publik në Kosovë në lidhje me komponentët specifikë të bashkëpunimit dhe integritit rajonal, duke theksuar nevojën për analiza të mëtejshme për të kuptuar faktorët themelorë që formësojnë këto perspektiva.

Tabela 13 BSBP 2021-2022 – PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR MBËSHTETJEN E LËVIZJES SË LIRË, SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT DHE NJË TREGU TË PËRBASHKËT PËR MALLRAT DHE FUQINË PUNËTORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

A E MBËSHTESNI LËVIZJEN E LIRË, SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT DHE NJË TREG TË PËRBASHKËT PËR MALLRAT DHE FUQINË PUNËTORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR?		Po	Jo	Nuk e di/ Nuk kam mendim
		2021 	67.2%	25.6%
2022 	69.9%	24%	6.1%	

PËRFUNDIMET

Niveli i qëndrueshëm dhe i lartë i mbështetjes në Kosovë për integrimin në BE, së bashku me perceptimin pozitiv të gatishmërisë së BE-së për të pranuar vendin, thekson rëndësinë e integritit në BE si një aspiratë e rëndësishme për Kosovën. Gjatë gjithë periudhës matëse trevjeçare, qytetarët e Kosovës kanë demonstruar vazhdimisht mbështetje të palëkundur për integrimin në BE, me dallime minimale të vërejtura. Pavarësisht ndryshimeve në pikëpamjet e të anketuarve gjatë kësaj periudhe, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve mbetën me shpresë për gatishmërinë dhe vullnetin e BE-së për ta pranuar Kosovën si shtet anëtar tani ose në të ardhmen.

Për më tepër, perceptimet e qytetarëve të Kosovës në lidhje me marrëdhëniet Kosovë-Serbi kanë dhënë një pasqyrë të dinamikës së procesit të dialogut dhe deponimit të përgjithshëm brenda vendit. Të dhënat e mbledhura nga BSBP shfaqën një spektër të gjerë opinionesh dhe këndvështrimesh. Edhe pse kishte luhatje në perceptimin e progresit të dialogut, u shfaq një temë konsistente: dëshira për përmirësimin e marrëdhënieve dhe zgjidhjen e çështjeve të kahershme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shumica e të anketuarve shprehën shpresën për një marrëveshje përfundimtare, ndonëse duke pranuar sfidat dhe pasiguritë e përfshira. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e dialogut të qëndrueshëm, masave për ndërtimin e besimit dhe përpjekjeve të vazhdueshme nga të dyja palët dhe komuniteti ndërkombëtar për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të marrëdhënieve Kosovë-Serbi, duke hapur rrugën për një të ardhme paqësore dhe prosperuese për të dy kombet dhe rajonin më të gjerë.

Nga ana tjetër, Iniciativa për Ballkanin e Hapur dhe bashkëpunimi në Ballkanin Perëndimor ishin gjithashtu objekt analize dhe vlerësimi në këtë raport. Të dhënat e mbledhura tregojnë perceptime evidente se shumica e qytetarëve të Kosovës mbështesin bashkëpunimin rajonal, lëvizjen e lirë dhe tregtinë. Megjithatë, kur u pyetën konkretisht për mbështetjen e tyre rreth idesë së Iniciativës për Ballkanin e Hapur, përgjigjet janë të ndara dhe një pjesë e konsiderueshme shpreh skepticizëm apo mungesë opinionin. Gjetjet nxjerrin në pah kompleksitetin e ndikimit të medias dhe narrativave politike, duke diversifikuar dhe duke ndikuar në opinionin publik. Duke ecur përpara, është thelbësore të merren parasysh këto perspektiva dhe të adresohen shqetësimet dhe keqkuptimet përmes komunikimit transparent dhe vendimmarrjes gjithëpërfshirëse, veçanërisht me synim për të nxitur dhe ndërtuar bashkëpunimin rajonal dhe iniciativat e përbashkëta.

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

316.653(496.51)(047)(063)"2020/2022"

327(496.51:497.11)

Sejdiu, Gramos

Pasqyrime mbi pikëpamjet e qytetarëve në periudhën 2020-2022 : integrimi në BE, marrëdhëniet Kosovë - Serbi dhe bashkëpunimi rajonal / Gramos Sejdiu, Dea Fetiu.

- Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2023. - 14 f. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-842-02-2



ISBN 978-9951-842-02-0



9 789951 842020